



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I ARKITEKTURËS

PLANI STRATEGJIK 2024-2028

Prishtinë, mars 2024

PËRMBATJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. HYRJE.....	6
3. METODOLOGJIA E PËRPILIMIT TË STRATEGJISË.....	7
4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE.....	7
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS.....	10
Objektivi strategjik 1 - Përsosmëria dhe Novacioni akademik	11
Objektivi specifik 1.1 – Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie me metoda të reja	11
Objektivi specifik 1.2 – Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit	12
Objektivi specifik 1.3 – Vlerësimi i programeve studimore sipas standardeve institucionale	13
Objektivi specifik 1.4 – Nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve.....	14
Objektivi specifik 1.5 – Vlerësimi dhe monitorimi i performacës akademike.....	15
Objektivi strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin	16
Objektivi specifik 2.1 – Rritja e pjesëmarrësve të rinj për avancim të teknologjisë dhe novacionit	17
Objektivi specifik 2.2 – Rritja e pjesëmarrësve me kualifikim të avancuar për kërkime shkencore	18
Objektivi specifik 2.3 – Krijimi i grupeve me pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë	19
Objektivi specifik 2.4 – Avancimi i Institutit për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm	20
Objektivi specifik 2.5 – Krijimi i Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji në AU.....	21
Objektivi strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve.....	22
Objektivi specifik 3.1 – Rishikimi i numrit të studentëve në programet studimore.....	22
Objektivi specifik 3.2 – Mobiliteti i studentëve me performancë të lartë.....	23
Objektivi specifik 3.3 – Sigurimi i teknologjisë informative për studentët.....	24
Objektivi specifik 3.4 – Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore për studentët	25
Objektivi strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare	26
Objektivi specifik 4.1 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare	27
Objektivi specifik 4.2 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet vendore.....	27
Objektivi specifik 4.3 – Pjesëmarrja në forumet shkencore vendore dhe ndërkombëtare	28
Objektivi specifik 4.4 – Promovimi i materialeve reciproke në nivel akademik dhe praktik	29
Objektivi specifik 4.5 – Promovimi i integritetit akademik.....	30

Objektivi strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet.....	32
Objektivi specifik 5.1 – Planifikimi i kampusit të FA.....	32
Objektivi specifik 5.2 – Zhvillimi i projekteve kërkimore-shkencore, akademike dhe profesionale	33
Objektivi specifik 5.3 – Përmirësimi dhe digjitalizimi i infrastrukturës së FA	34
Objektivi specifik 5.4 – Promovimi, menaxhimi dhe komercializmi i pronësisë akademike	35
Objektivi specifik 5.5 – Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies	37
6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	38
7. NDIKIMI BUXHETOR I STRATEGJISË.....	38

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
FA	Fakulteti i Arkitekturës
IKAU	Instituti për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm
IPAU	<i>International Plaform i Architecture and Urbanism</i>
KQSC	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akademike
PS	Programet Studimore
PSFA	Plani Strategjik i Fakultetit të Arkitekturës
PSUP	Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës
QEQ	Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri
QNLT	Qendra për Novacion, Laborator dhe Teknologji
QPM	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
QUGJ	Qendra Universitare për Gjuhë
QZHK	Qendra për Zhvillimin e Karrierës
SHU	Shoqatat e Universitetit
TI	Teknologjia e Informacionit
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Ndihma e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
ZMJ	Zyra për Marrëdhënie me Jashtë
ZKPS	Zyra për Kërkime, Projekte të Sponsorizuara
ZZHC	Zyra për Zhvillim të Cilësisë

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Fakulteti i Arkitekturës (FA) në harmoni me Planin Strategjik 2023-2027 të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) dhe Strategjinë e Arsimit 2022-2026 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ka identifikuar objektivat strategjike, me qëllim që të avancojë pozitën konkurruese në ofrimin e shërbimeve cilësore për nevojat në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit për qytetarët e Kosovës dhe më gjer. Për të arritur këtë qëllim, janë identifikuar prioritetet e tyre duke u bazuar në kapacitetet dhe resurset njerëzore, financiare dhe logjistike. Në këtë mënyrë që të zhvillohen dhe udhëhiqen drejt përmbushjes së objektivave strategjike, respektivisht në fushat me prioritet si në vijim:

- **Përsosmëria dhe Novacioni akademik:** rishikimi dhe përditësimi i programeve studimore dhe kurrikulës për të pasqyruar zhvillimet në fushat e arkitekturës dhe urbanizmit, përfshirë metodat e mësimdhënies inovative dhe teknologjinë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- **Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin:** inkurajimi dhe mbështetja e anëtarët e fakultetit për të kryer veprimtari kërkimore-shkencore dhe profesionale me cilësi dhe standard të lartë ndërkombëtar dhe nxitja e tyre për të siguruar burime financiare për aktivitetet kërkimore, profesionale, kulturore dhe sociale.
- **Suksesi dhe Mbështetja e studentëve:** sigurimi i suksesit dhe mirëqenies së studentëve duke ofruar këshillim akademik, mentorim dhe mbështetje për të arritur qëllimet e tyre akademike dhe profesionale, duke promovuar diversitetin dhe gjithëpërfshirjen.
- **Angazhimi dhe Shtrirja vendore dhe ndërkombëtare:** ndërtimi i lidhjeve me komunitetin lokal dhe ndërkombëtar, partnerët e industrisë dhe organizatat profesionale, duke organizuar ngjarje publike dhe bashkëpunuar në projekte kërkimore dhe profesionale në Hapësirën Evropiane të Arsimit të lartë dhe Ndërmarrjet dhe Studiot vendore dhe evropiane në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit.
- **Infrastruktura dhe Burimet:** sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur mësimin, kërkimin dhe shërbimin profesional, përfshirë investimin në bibliotekë, Institutin për kërkim në arkitekturë dhe urbanizëm, në Qendrën për novacion, laborator dhe teknologji, në hapësira për studio e në pajisje moderne, e cila është në përputhje me trendët e transformimit digjital.

Plani Strategjik i Fakultetit të Arkitekturës (PSFA) ka pesur objektiva strategjike, të përcaktuara për pesë fushat prioritete. Objektivat strategjike adresojnë problemet kyçe të fushave me prioritet të FA dhe janë zbrëthyer në objektiva specifike të cilat ndërlidhen me shkaqet kryesore të problemeve kyçe përkatëse dhe synojnë rezultate praktike në një kohë afatshkurtër. Për secilin objektiv specifik janë identifikuar aktivitetet që shpijnë në arritjen e objektivit sipas fushave me prioritet.

2. HYRJE

Studimet për Arkitekturë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP), filluan si një nga katër (4) departamentet e Fakultetit Teknik, i themeluar në vitin 1961. Nga viti 2019, Fakulteti i Arkitekturës (FA) është një nga katërbëdhjetë (14) njësitë e pavarura të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" institucion publik, më i madhi në vend në ofrimin e arsimit të lartë. Qëllimi i FA në kuadër të UP është promovimi i jetës akademike dhe intelektuale dhe i ndryshimeve arkitektonike e urbanistike në varësi të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore drejt përparimit të vendit dhe shoqërisë kosovare. FA mban përgjegjësinë shtetërore dhe qytetare në edukimin e të rinjve të Kosovës për t'u përgatitur si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për nevojat e zhvillimit arkitektonik dhe urbanistikë të vendit dhe më gjer.

FA në vijimësi ka dhënë kontribut në komunitetin akademik, duke iu ofruar studentëve e alumnive kohë dhe hapësirë për të reflektuar mbi trashëgiminë e pasur të studimeve për arkitekturën. Me krenari feston gjysmë shekullin e krijimit të kuadrove, arritjeve dhe ndikimit domethënës të arkitektëve të diplomuar, në mjedisin e projektuar e të ndërtuar në vend, rajon e më gjer. Në kuadër të UP-ja, FA i ka mbijetuar kohës dhe ka qenë udhëheqëse në ofrimin e nxënies së dijes dhe zhvillimit të arkitektëve të ri.

Megjithatë, krahas UP, edhe FA përballet me sfida objektive për të përmbushur kërkesat e studentëve dhe shoqërisë në përgjithësi, për të mbajtur hapin dhe për të plotësuar nevojat e ekonomisë kosovare. Ndonëse ka punuar pa ndërprerje në mësimdhënie dhe ngritje të cilësisë së studimeve të arkitekturës në kuadër të arsimit të lartë; në kërkime të vazhdueshme shkencore në fushat e arkitekturës, me fokus në projektim arkitektonik; urbanizëm dhe planifikim hapësinor; qëndrueshmërinë urb-arkitektonike; trashëgimi arkitekturale; teknologji të aplikuar në arkitekturë; dhe eficientë të energjisë; në shërbim të shoqërisë dhe vendit; arsimim të lartë të kuadrove profesionalisht kompatible me kërkesat e tregut dhe me standardet evropiane; aktivitete profesionale në fushat e arkitekturës për përmbushjen e kërkesave të ekonomisë së tregut e të institucioneve publike shtetërore; zhvillim të teknologjisë dhe novacionit në fushën e arkitekturës; duke ndjekur trendët e arsimit të lartë në Evropë dhe SHBA.

Si pasojë e situatës aktuale dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë, FA ka punuar në Planin Strategjik për të adresuar sfidat dhe nevojat aktuale. Pas identifikimit të tyre, në bashkëpunim me Këshillin e Fakultetit dhe dekanin, është krijuar Grupi punues për hartimin e dokumentit "Plani Strategjik i FA 2024-2028", që synon të përmirësojë cilësinë e të gjitha shërbimeve të FA. Për të organizuar dhe implementuar aktivitetet e planifikuara në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, efektive dhe eficiente, grupi punues ka ndarë këto aktivitete dhe nevoja në pesë shtylla kryesore – objektiva strategjike, me degëzimet në objektiva specifike, të cilat janë prezantuar në dokument, të prezantuara në formë tabelare për të lehtësuar leximin dhe ekzekutimin e tyre.

Njësitë akademike, FA i UP pritët që të hartojnë planin e veprimit për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve brenda tyre. Plani i Veprimit, i cili do t'i bashkëngjitet Planit Strategjik, do të vazhdojë të përmirësohet me kontributet nga palët e interesuara brenda dhe jashtë fakultetit, të miratuara nga universiteti, në mënyrë që të jetë sa më konkret në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Plani i Veprimit po ashtu përmban edhe koston e përafërt financiare të secilit veprim.

3. METODOLOGJIA E PËRPILIMIT TË STRATEGJISË

Konform ndërtimit të mjaftueshëm institucional të FA nga themelimi me datë 01.10.2019 e deri më tani, proceseve të akreditimit, si dhe mbështetur në Planin Strategjik të UP të publikuar me datë 24.10.2023, janë plotësuar kushtet për hartimin e planit strategjik të FA që parqet vizionin, objektivat, treguesit, vlerat e synuara dhe veprimet e planifikuara lidhur me zhvillimin e mëtutjeshëm të tij në periudhën 4 (katër) vjeçare.

Bazuar në kompetencat që përcaktohen sipas nenit 72 dhe 26 të Statutit të UP, Këshilli i Fakultetit të Arkitekturës merr Vendim, për emërimin e grupit punues për hartimin e Planit Strategjik të FA me nr. prot. 3248/1 të datës 31.10.2023. Kjo strategji do të udhëheqë të gjitha aktivitetet zhvillimore të FA dhe do të përdoret si tregues i performancës së strukturave menaxhuese të fakultetit.

Grupi punues për hartimin e Planit të Strategjisë së FA përbëhet nga 7 anëtarë, Prof.dr. Violeta Nushi në cilësinë e kryesueses së komisionit dhe anëtarët, Prof.asoc.dr. Vlora Navakazi, Prof.asoc.dr. Teuta Jashari Kajtazi, Prof.ass.dr. Arta Xhambazi, Prof.ass.dr. Rozafa Basha, Prof.ass.dr. Dukagjin Hasimja, dhe Prof.ass.dr. Miranda Rashani. Komisioni ka bërë një përgatitje fillestare duke kompletuar dokumentacionin relevant për hartimin e Planit Strategjik të Fakultetit të Arkitekturës, duke përfshirë dokumentet strategjike të MASHT-it për arsimin e lartë, dokumentet sektoriale dhe strategjike të UP dhe dokumentet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Përgatitja e dokumentit ka ndjekur një dinamikë të miratuar nga Këshilli i Fakultetit, duke përfshirë fazat e draftit të dokumentit nga Grupi punues i vendosur nga Këshilli i FA, finalizimin e dokumentit për diskutim publik me mësimdhënësit dhe përfaqësuesit e studentëve para se të aprovet nga Këshilli i Fakultetit.

Grupi punues ka mbajtur takime pune dhe konsultative për të përcaktuar prioritetet dhe për të hartuar një draft fillestar të dokumentit. Ky draft është dërguar për kontributet shtesë tek personeli i rregullt akademik, personeli administrativ dhe përfaqësuesit e studentëve të FA brenda 29.03-05.04.2024, respektivisht pas punëtorisë së datës 29.03.2024.

Grupi Punues falënderon të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e Planit Strategjik të FA 2024-2028 në çfarëdo forme.

4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE

Veprimtaria e Fakultetit të Arkitekturës është e bazuar në Statutin dhe rregulloret përkatëse të Këshillit Drejtues dhe të Senatit të Universitetit të Prishtinës. Raportet vjetore të punës vërtetojnë se FA ka arritur të ndjekë dhe të realizojë objektivat kryesore strategjike në mënyrë të suksesshme. Ky sukses kompleks mund të i atribuohet përkushtimit dhe angazhimit të strukturave menaxhuese, personelit akademik dhe administrativ, si dhe studentëve të FA. Në të gjitha fushat kryesore strategjike të veprimtarisë së FA, janë shënuar rezultate të rëndësishme, që tregojnë se ky institucion ka arritur të ndërtohet në aspektin institucional dhe organizativ brenda një periudhe relativisht të shkurtër, ndonëse në mungesë të personelit administrativ dhe të hapësirës arkitektonike.

Fakulteti i Arkitekturës në momentin e procesit të vlerësimit ka Departamentin e Arkitekturës dhe Departamentin e Eficiencës së Energjisë, me programet studimore, aktive o/dh në proces të akreditimit:

- BSc në Arkitekturë, tre (3) vjeçar, me 180 ECTS kredi;
- Msc në Arkitekturë me specializime, dy (2) vjeçar, me 120 ECTS kredi;
- MSc në Arkitekturë, i integruar me BSc, pesë (5) vjeçar, me 300 ECTS kredi; dhe
- MSc në Eficiencë të Energjisë, dy (2) vjeçar, me 120 ECTS kredi.

Programet studimore aktuale në Arkitekturë dhe në Eficiencë e Energjisë, në mënyrë të përgjithshme përbëhen nga: Lëndët Obligative, Lëndët Zgjedhore dhe Punimi i temës së diplomës së nivelit Bachelor Shkencor, Master Profesional ose/ dhe Master Shkencor, të cilat janë të bazuara në arritjen e njohurive profesionale, kërkimore shkencore dhe multidisiplimore sipas nevojës së programeve studimore.

Aktualisht FA ka aktive dy programe studimore, programi studimor aktual Bachelor Shkencor në Arkitekturë që është tre (3) vjeçar, që ka njëqind e tetëdhjetë (180) ECTS-së kredi, respektivisht ka gjashtë (6) semestra, përfshirë këtu edhe punimin e diplomës; programin studimor Master Shkencor në Arkitekturë me Specializime, dy (2) vjeçar që ka njëqind e njëzet (120) ECTS kredi respektivisht katër (4) semestra, përfshirë këtu edhe punimin e diplomës; si dhe programin studimor Master Shkencor në Eficiencë e Energjisë, që është dy (2) vjeçar, që ka njëqind e njëzetë (120) ECTS kredi, respektivisht ka katër (4) semestra, përfshirë këtu edhe punimin e diplomës, që u aktualizua në vitin akademik 2023/2024. Aktualisht ka në shuarje dy programe studimore: Master Shkencor në Arkitekturë, i integruar me Bachelor, që është pesë (5) vjeçar, që ka treqind (300) ECTS kredi, respektivisht dhjetë (10) semestra, përfshirë mundësinë e punimit të njërit nga dy punimer e diplomës, të nivelit BSc apo MSc, që përfundon me gjeneratën e pranuar në vitin akademik 2020/2021; dhe programin studimor Master Profesional në Eficiencë e Energjisë, program një (1) vjeçar, që ka pasë gjashtëdhjetë (60) ECTS kredi, respektivisht ka pasur dy (2) semestra, përfshirë këtu edhe punimin e diplomës, që përfundon me gjeneratën e pranuar në vitin akademik 2021/2022.

Në kontekstin e zhvillimeve pozitive në vitin 2023, si vit bazë për vlerësimin e ndikimit të Strategjisë 2024-2028, duhet të theksohet që FA ka arritur të zhvillojë më tutje strukturat ndërvepruese ndërmjet programeve akademike dhe aktorëve të tregut të punës si dhe është në proces të ndërtimit të skemave, të cilat mundësojnë që gjetjet nga ndërveprimi i tillë të reflektohen në programet akademike dhe në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së studimeve. Po ashtu, është vazhduar me ngritjen akademike të personelit akademik dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet ofrimit të vazhdueshëm të trajnimeve, të cilat janë të fokusuar në mbështetjen e mësimdhënësve nëpërmjet demonstrimit të praktikave më të mira, respektivisht në aplikimin e metodave kreative dhe aktivizuese karakteristike për mësimdhënien moderne.

Me qëllim të sigurimit të përtëritjes personelit akademike dhe ofrimit të mundësive për gjeneratat e reja me përgatitje adekuate, FA përmes mekanizmave administrativ të UP-ja ka realizuar me sukses konkursin publik, nëpërmjet të cilit janë punësuar një numër i konsiderueshëm i asistentëve dhe profesorëve të rinj, të cilët pritet të sjellin një dinamikë të re në procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore në vitet që pasojnë. Rezultate të mira janë shënuar edhe në fushën e kërkimit shkencor, ku është shënuar një rritje domethënëse e publikimeve shkencore në revista kredibile shkencore, shprehur në figurën 1.




Figura 1 – Aktiviteti shkencor i stafit mësimdhënës.

Po ashtu në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe vendor janë shënuar rezultate domethënëse, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare dhe vendore. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë rezultuar me disa projekte të rëndësishme kurrikulare në të cilat kanë përfituar studentët në veçanti.

Përkundër progresit të shënuar në gjitha fushat me prioritet relevant të veprimtarisë së FA, të prezantuara në Raportin e vitit 2023 me nr. prot. 3930/1 të datës 21.12.2023, FA vazhdon të ballafaqohet me sfida të natyrave të ndryshme. Një ndër sfidat kryesore, me të cilat është ballafaquar FA në vitin 2023 dhe e cila pritet të vazhdojë në të ardhmen, është ruajtja e akreditimit të programeve ekzistuese akademike dhe zhvillimi i programeve të reja në kontekstin e standardeve të reja të akreditimit, nevojave të shoqërisë dhe vendit. Sfidat tjera të identifikuar janë realizimi i konkurseve për personel akademik në periudha të rregullta kohore, duke ruajtur standardin tashmë të krijuar; përmirësimi i shërbimeve administrative dhe rritja e efikasitetit të këtij shërbimi nëpërmjet realizimit të konkurseve për personel administrativ dhe plotësimi i pozitave të lira me individ të përzgjedhur me procedura transparente; dhe pamundësia e zgjerimit të hapësirave të fakultetit për shkak të mungesës së certifikatës së shfrytëzimit të lokacionit që kanë ngecur procedurat e prokurimit për realizimi e projekteve kapitale.

Pamundësia e zhvillimi infrastrukturor me hapësira të reja arkitekturale që potencialisht ka kampusi i FA, mbetet sfida e cila që ka afekte ko-laterale, si: mosrealizimin efikas e në kohë i funksionalizimit të Institutit për Kërkime për Arkitekturë dhe Urbanizëm (IKAU); mosfunksionalizimin e mekanizmave të rinj dhe zhvillimit të mëtejshëm të atyre ekzistues për nxitjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore; pengesat për rrjetëzimin, socializmin dhe aktiviteteve kulturore të studentëve; planifikimin e pezulluar të përmirësimit të infrastrukturës për Qendrën për Novacion, Laborator dhe Teknologji (QNLT) për nevoja akademike dhe për nevoja të shërbimeve e të cilat janë të kërkuara në akreditimet pasuese. Ngadalësimi i procesit të rekrutimit të kuadrit administrativ dhe ngecja e zhvillimit infrastrukturor afekton në ngadalësimin e shumë shërbimeve, rrjedhje jo efikase të procesit mësimdhënies, mësimnxënies dhe administrativ, të veprimtarisë kërkimore-shkencore, dhe pamundësisë së mbështetjes së studentëve.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS

Ky plan strategjik ka pesë objektiva strategjike që janë ndarë në nga pesë objektiva specifike, të radhitura më tutje jo sipas rëndësisë, të cilat përfshijnë treguesit për matjen e arritjes së objektivit, afatet kohore, personelit përgjegjës dhe burimet e nevojshme për t'i realizuar. Renditja e këtyre objektivave specifike ofron fusha me fokus për katër vitet e ardhshme në FA.

Listimi i prioriteteve shpreh një përmbledhje të fushave me fokus institucional që duhet të konsiderohen, por progresi dhe fokusi duhet të rishikohen rregullisht, së paku një herë në vit, duke u bazuar në treguesit dhe në një proces periodik formal të rishikimit dhe rivlerësimit të planit të veprimit. Objektivat specifike janë hartuar me qëllim që secili të jetë i veçantë, ndonëse duken të përsëritur në kuadër të matricës komplekse dhe gërshetimit të tyre në raport me objektivat strategjike.

Objektivat strategjike janë prezantuar në formë tabelore për të lehtësuar leximin dhe ekzekutimin e tyre. Njësia akademike, Fakulteti i Arkitekturës i Universitetit të Prishtinës pritet që të hartojë Planin e Veprimit për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve brenda tyre. Plani i Veprimit, i cili do t'i bashkëngjitet Planit Strategjik, do të vazhdojë të përmirësohet me kontributet nga palët e interesuara brenda dhe jashtë fakultetit, të miratuara nga universiteti, në mënyrë që të jetë sa më konkret në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Plani i Veprimit po ashtu do përmban edhe koston e përafërt financiare të secilit veprim.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Përsosmëria dhe Novacioni akademik
OBJEKTIVI STRATEGJIK 2	Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin
OBJEKTIVI STRATEGJIK 3	Suksesi dhe Mbështetja e studentëve
OBJEKTIVI STRATEGJIK 4	Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare
OBJEKTIVI STRATEGJIK 5	Infrastruktura dhe Burimet

Fakulteti i Arkitekturës ka përcaktuar treguesit për matjen e arritjes së objektivave strategjike dhe cakun e synuar në vitin 2028. Arritja e objektivave strategjike do të rezultojë me rezultate më të larta të studentëve, rritje të numrit të studentëve dhe rritje të numrit të diplomuarve; rritje të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie; përmirësim të pozitës së FA në arenën ndërkombëtare; digjitalizim të shërbimeve administrative dhe të mësimdhënies; përmirësim të infrastrukturës, burimeve, mjeteve të punë si dhe fuqizim të qeverisjes dhe menaxhimit financiar.

Objektivi strategjik 1 - Përsosmëria dhe Novacioni akademik

Me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, kjo strategji parasheh disa objektiva specifike, sikurse inkurajimi i përsosmërisë në mësimdhënie përmes aplikimit të metodave inventive; rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit; zbatimi i standardeve të larta për vlerësimin ndër-institucional si dhe vlerësimi i programeve studimore; rritje të përfshirjes dhe angazhimit të studentëve; dhe si rritje të performancës akademike.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Përsosmëria dhe Novacioni akademik
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1	Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie me metoda të reja
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2	Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3	Vlerësimi i programeve studimore sipas standardeve institucionale
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4	Nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.5	Vlerësimi dhe monitorimi i performancës akademike

Objektivi specifik 1.1 – Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie me metoda të reja

Për të nxitur përsosmërinë në mësimdhënie, do të përdorën tregues të qartë sikurse krahasimi i niveleve të numrit të të diplomuarve që do të i shërben rritjes së të diplomuarave, rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit, vlerësimi i programeve studimore sipas standardeve institucionale, nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve dhe vlerësimi dhe monitorimi i performancës akademike, që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Strategjia synon të rrisë numrin e të diplomuarve për 15% nga trendi aktual, sikurse edhe nivelin e vlerësimeve nga ana e studentëve. Për më tepër, ky objektivi synon që brenda periudhës së zbatimit të Strategjisë rreth 10% e personelit akademik nga numri total të marrin pjesë në trajnime në lidhje me mësimdhënien, meqë pothuajse 90% e personelit kenë kualifikimet e duhura. Për më tepër, Strategjia synon që brenda katër vjetëve të arrihen të paktën edhe katër marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare për të mundësuar qasje në shkëmbim të përvojave në metodologjinë e mësimdhënies përmes mobilitetit.

Objektivi Strategjik 1 – Përsosmëria dhe Novacioni akademik

Objektivi specifik 1.1 – Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie me metoda të reja

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Norma më të larta të diplomimit	15% rritje nga trendi aktual
Komente/vlerësime nga ana e studentëve	15% rritje nga trendi aktual
Kualifikimet e personelit akademik	90% e personelit akademik të kenë kualifikimet e duhura
Trajnimi i vazhdueshëm i personelit akademik në kuadër të UP	90% e personelit akademik të marrin pjesë në trajnime në lidhje me mësimdhënien të paktën dy herë
Të ofrohen trajnime të brendshme mbi metodologjitë e reja të mësimdhënies në fushat e arkitekturës dhe urbanizmit	2 sesione në vit
Qasja në shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare	4 marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare të reja
Qasja në resurse të cilësisë të UP	15% rritje nga trendi aktual i qasjes
Veprimet e planifikuara	
1.1.1	Zhvillimi i kurseve të specializuara për personelin e mësimdhënies në teknikat dhe metodot e reja të mësimdhënies, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
1.1.2	Nxitja e personelit akademik për një qasje më aktive dhe praktike për mësimin përmes zhvillimit të aktiviteteve të mësimdhënies bazuar në projekte dhe punë praktike/laboratorike, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
1.1.3	Sigurimin që studentët të kenë qasje në teknologjitë dhe mjetet më të fundit për të mësuar dhe praktikuar nxëniet, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
1.1.4	Krijimi i një kulture novative në mësimdhënie nëpërmjet konkurrencës dhe ndarjes së praktikave të mira mes mësimdhënësve, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
1.1.5	Ngritja e programeve dhe bursave për mësimdhënësit dhe studentët për të studiuar dhe praktikuar metodat e reja për metodologji të suksesshme të mësimdhënies, referua niveleve ndërkombëtare dhe konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP.

Objektivi specifik 1.2 – Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet përmes rishikimit dhe avancimit të programeve të studimit. Ky objektivi specifik do të matet duke vlerësuar shkallën e suksesit të studentëve në provime, me ç' rast synohet që brenda katër viteve të ardhshme të rritet shkalla e kalueshmërisë prej 10%.

Tregues tjetër për arritjet e këtij objektivi do të jetë niveli i diplomimit të studentëve. Strategjia synon të rrisë nivelin e diplomimit për 15%, numrin e kandidatëve që aplikojnë për të studiuar në FA dhe shkallën e punësimit për 15%. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet edhe përmes përdorimit të teknologjisë së re informative dhe materialeve moderne studimore. Këta tregues do të maten duke prezantuar platforma të reja novative / virtuale të mësimi.

Objektivi Strategjik 1 – Përsosmëria dhe Novacioni akademik	
Objektivi specifik 1.2 – Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Shkalla e suksesit të studentëve në provime	Rritja e kalueshmërisë prej 10% më shumë
Shkalla e diplomimit të studentëve	15% rritje nga trendi aktual duke respektuar rregulloret në fuqi
Përdorimi i pajisjeve të TI-së dhe materialeve studimore në mësimdhënie	Prezantimi i platformave të reja, krijimi i podkasteve, shkrimit/prezantimit virtual, e të tjera.
Rritja e numrit të kandidatëve për të studiuar në FA	15% rritje në numrin e kandidatëve, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Rritja e numrit të Programeve Studimore	1 PS PhD, 1 PS MSc të integruar (300 ECTS kredi) dhe 3 PS MSc (120 ECTS kredi)
Shkalla e punësimit të studentëve pas diplomimit	15% rritje nga numri aktual, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	
1.2.1	Hartimi i kurrikulave efektive që përfshijnë vlerësime të vazhdueshme
1.2.2	Krijimi i programeve të reja të studimit (PhD, MSc integruar me BSc, dhe MSc)
1.2.3	Analiza e nevojave të tregut të punës dhe promovimi i bashkëpunimit me industrinë
1.2.4	Konsultime me studentët dhe mësimdhënësit dhe monitorimi i performancës së studentëve
1.2.5	Promovimi i programeve të studimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e studentëve dhe punëdhënësve

Objektivi specifik 1.3 – Vlerësimi i programeve studimore sipas standardeve institucionale

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies synohet të arrihet edhe përmes zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional. Standardet e vlerësimit do të kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo do të matet duke vlerësuar performancën akademike të studentëve, rritjen e përfshirjes së

profesorëve ndërkombëtar, zhvillimin e programeve të brendshme të trajnimit, mobilitetin në mësimdhënie dhe rritjen e shkallës së kënaqshmërisë së studentëve me përmbajtjen e programit të studimit. Zbatimi i këtyre aktiviteteve do të kontribuojë në rritjen e shkallës së diplomimit për të paktën 15%.

Objektivi Strategjik 1 – Përsosmëria dhe Novacioni akademik	
Objektivi specifik 1.3 – Vlerësimi i programeve studimore sipas standardeve institucionale	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Performanca akademike e studentëve	15% rritje e shkallës së diplomimit
Përfshirja e profesorëve ndërkombëtarë	15% rritje nga trendi aktual
Programe për zhvillimin profesional të personelit akademik	Zhvillimi i dy programeve të brendshme të trajnimit
Vlerësimi ndërkolegial	50% rritje nga trendi aktual
Performanca e personelit akademik në mësimdhënie	10% rritje e shkallës së kënaqshmërisë me përmbajtjen e programit të studimit
Veprimet e planifikuara	
1.3.1	Identifikimi i standardeve të vlerësimit për sigurimin e cilësisë së brendshme bazuar në treguesit e UP dhe FA
1.3.2	Zhvillimi i planeve të vlerësimit, referuar planeve të UP që do derivojnë planet e FA
1.3.3	Kryerja e vlerësimit dhe monitorimit të rregullt përmes mekanizmave të UP
1.3.4	Analiza dhe interpretimi i të dhënave përmes mekanizmave të UP
1.3.5	Përmirësimi i performancës

Objektivi specifik 1.4 – Nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve

Një ndër objektivat specifike në kuadër të objektivit të parë strategjik, është edhe rritja e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje. Kjo do të mundësohet përmes plotësimit apo nxjerrjes së rregullore të reja. Ky objektivi synon edhe rritjen e mundësive për angazhimin e studentëve si asistentë në mësimdhënie dhe në projekte kërkimore. Kjo do të arrihet duke shtuar mundësitë për shërbime të veçanta për konsultime. Strategjia synon rritjen e angazhimit të universitetit, rrjedhimisht edhe të fakultetit për të ndihmuar studentët të gjejnë punë praktike. Për më tepër, referuar Planit të Strategjisë së UP, PSFA synon krijimin e kushteve operative për organizatat studentore, dhe kjo do të kontribuojë në rritjen prej të paktën 20% të aktiviteteve të organizuara nga studentët. Ky objektivi specifik parasheh edhe rritjen e aktiviteteve të alumnit të FA, duke ndihmuar në organizimin e të paktën dy ngjarjeve në vit.

Objektivi Strategjik 1 – Përsosmëria dhe Novacioni akademik	
Objektivi specifik 1.4 – Nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje	Konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Përfshirja e studentëve në cilësinë e asistentëve hulumtues	2 asistentë për punë kërkimore me pagesë, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Hapësira për organizatën/at studentore	20% më shumë të hapësirë për organizata dhe aktivitete të organizuara nga studentët
Përfshirja e asistentëve në mësimdhënie	80% e profesorëve të kenë së paku nga një asistent të marrëdhënie të rregullt në mësimdhënie
Rritja e numrit të ngjarjeve nga ana e alumnit	2 ngjarje në vit
Asistimi i studentëve të gjejnë punë praktike në kuadër të IKAU dhe QNLT	20% më shumë i numrit të studentëve që aplikojnë për punë praktike
Veprimet e planifikuara	
1.4.1	Promovimin dhe ofrimin e mundësive për studentët që të përfshihen në kërkim shkencor
1.4.2	Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë
1.4.3	Përmirësimi i shërbimeve për studentë
1.4.4	Krijimi i klubeve të interesit që mund të ndihmojnë në nxitjen e angazhimit dhe krijimin e lidhjeve me studentët si dhe organizimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore
1.4.5	Mundësimi i punës vullnetare që mund të ndihmojë në rritjen e ndjeshmërisë sociale dhe në zhvillimin e aftësive të ndryshme

Objektivi specifik 1.5 – Vlerësimi dhe monitorimi i performacës akademike

Vlerësimi dhe monitorimi i performancës akademike si ndikon direkt në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për ta arritur këtë objektivi specifik në kuadër të përsosmërisë dhe novacionit akademik, fakulteti do të përcjellë udhëzimet që do dalin nga universiteti, përkatësisht do të angazhohet që kartela e performancës të zbatohet në përpikëri; do të ofrohen të paktën 10 trajnimeve speciale të cilat mbështesin të mësuarit, dhe ofrimin e qasjes në resurse të cilësisë përmes qasjes në databaza ndërkombëtare. Për më tepër, ky objektivi strategjik synon që të rrisë edhe nivelin e punës në grupe dhe diskutimeve në ligjërata. Ndër veprimet e planifikuara është edhe njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime, duke përfshirë edhe punën praktike që është e domosdoshme në mësimnxënien.

Objektivi Strategjik 1 – Përsosmëria dhe Novacioni akademik	
Objektivi specifik 1.5 – Vlerësimi dhe monitorimi i performancës akademike	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Vlerësimi në Kartelën e Performancës	Kartela e performancës të zbatohet me përpikëri
Metodat e vlerësimit mbështesin të mësuarit	Prezantimi i metodave të reja të vlerësimit, 2 trajnimeve speciale në vit, të udhëhequra nga UP
Mësimdhënësit kanë qasje në resurse të cilësisë	Kartela e performancës të zbatohet me përpikëri
Puna në grupe dhe diskutimet në ligjërata	5% numër më i madh i punës në grupe
Veprimet e planifikuara	
1.5.1	Krijimi i sistemeve efektive të vlerësimit, referuar rregulloreve dhe standardit të UP
1.5.2	Promovimi i integritetit akademik
1.5.3	Njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime
1.5.4	Investimi në infrastrukturë dhe burime përmes UP
1.5.5	Përqendrimi në programet e specializuara dhe standardizuara për fushat e studimit

Objektivi strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Përmes avancimit të shkencës dhe novacionit, plani strategjik synon që të bëhet edhe ndërlidhja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe profesionale me ekonominë, tregun dhe industrinë. Për ta arritur këtë objektivi, PSFA parashihet rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete kërkimore, përmes rritjes së pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës, arkitekturës, urbanizmit dhe inxhinierisë, përmes rritjes së *output*-eve për njohuritë relevante që i përgjigjen ekonomisë, tregut dhe industrisë dhe njohuritë për projektet dhe novacionet nga këto institucione. Po ashtu synohet krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendas në zhvillimin global përmes projekteve sikurse *Horizon Europe*, si dhe përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimit të ndërtesave të reja për të mbështetur kërkimin-shkencor, akademik dhe profesional.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2	Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin
-------------------------------	--

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1	Rritja e pjesëmarrësve të rinj për avancim të teknologjisë dhe novacionit
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2	Rritja e pjesëmarrësve me kualifikim të avancuar për kërkime shkencore
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3	Krijimi i grupeve me pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.4	Avancimi i Institutit për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.5	Krijimi i Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji

Objektivi specifik 2.1 – Rritja e pjesëmarrësve të rinj për avancim të teknologjisë dhe novacionit

Plani Strategjikë FA parasheh veprime konkrete me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe novacionit që do i shërben shoqërisë dhe vendit. Synohet që të paktën të përfitohet një nga dhjetë garantët në vit që parashihen të ofrohen për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj në nivel të UP. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, PSFA parasheh mentorim të veçantë të studiueseve të rinj nga kolegët e tyre më të vjetër. Kjo do të ndikojë edhe në rritjen e studentëve si asistent hulumtues. Strategjia parasheh edhe mundësi/trajnime për vetë-zhvillim në fushën e specializimit si dhe tërheqjen e alumnit për të punuar në FA.

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin	
Objektivi specifik 2.1 – Rritja e pjesëmarrësve të rinj për avancim të teknologjisë dhe novacionit	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Grante për studiuesit/hulumtuesit e rinj	1 grant në vit, konform PS dhe rregulloreve të UP
Mundësi mentorimi të studiuesve/hulumtueseve të rinj	Mentorim i veçantë i ofruar nga kolegët më të vjetër
Përfshirja e studentëve si asistent hulumtues	2% më shumë asistentë hulumtues konform Statutit, Strategjisë dhe Rregulloreve të UP dhe Zhvillimit Akademik të FA-së
Përfshirja e organizatave studentore në marrjen e vendimeve	Konform Statutit dhe Rregulloreve në fuqi në kuadër të UP
Mundësi/trajnime për vetë-zhvillim në fushën e specializimit	Konform Statutit, Strategjisë dhe Rregulloreve të UP

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin	
Objektivi specifik 2.1 – Rritja e pjesëmarrësve të rinj për avancim të teknologjisë dhe novacionit	
Joshja e alumnit për të punuar në FA	Konform Statutit, Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	
2.1.1	Krijimi i grupeve të përbashkëta hulumtuese shkencore me universitetet tjera ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të platformave për aplikim në programe/grande Evropiane
2.1.2	Lidhja e rezultateve shkencore me ekonominë dhe aplikimi i drejtpërdrejtë me industri si dhe patentimin e tyre
2.1.3	Zhvillimi i kërkesave për kërkime shkencore duke përmirësuar infrastrukturën ekzistuese me fokus në laboratorë dhe hapësira përcjellëse me qëllim të arritjes së synimeve të ekuivalentimit me universitetet tjera
2.1.4	Tendenca për krijimin e PhD të përbashkëta sipas marrëveshjeve me Universitetet tjera ndërkombëtare dhe targetimit për Diplomë e dyfishtë PhD
2.1.5	Rritja e bashkëpunimit me kërkesat e tregut kombëtarë dhe ndërkombëtarë përmes adaptimit/përshtatjes/ të programeve ekzistuese të studimeve dhe tendenca për programe të reja konform kërkesave të tregut të lirë të punës

Objektivi specifik 2.2 – Rritja e pjesëmarrësve me kualifikim të avancuar për kërkime shkencore

Duke rritur bashkëpunimin me palët e interesit, Plani Strategjik FA synon që të rrisë mundësitë për skema të punësimit afatshkurtër dhe afatgjatë. Ndër veprimet kryesore për arritjen e këtij objektivi është edhe organizimi i tryezave të përbashkëta me grupet e interesit dhe organizimi i punëtorive.

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin	
Objektivi specifik 2.2 – Rritja e pjesëmarrësve me kualifikim të avancuar për kërkime shkencore	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Skema shtesë për punësim afatshkurtër	Persona të rinj të punësuar, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Skema shtesë për punësim afatgjatë	Persona të rinj të punësuar, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Skemat e shkëmbimit	Persona të rinj të punësuar, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.2 – Rritja e pjesëmarrësve me kualifikim të avancuar për kërkime shkencore

2.2.1	Të dhënat për interesimin e zhvillimit të fushave specifike si kërkesa nga FA, dhe ekonomia vendore dhe/ose të ndërmjetësuar nga UP
2.2.2	Baza e grupeve në dizpozicion për arritjen e objektivave në fushat përkatëse.
2.2.3	Organizimi i tryezave të përbashkëta me palët e interesit
2.2.4	Krijimi i grupeve të fushave të ngushta me orientime / specializime drejt avancimeve për arritjen e caktuar të dëshiruar.
2.2.5	Organizimi i punëtorive me fokus nga Fakultetet vendore dhe të jashtme si dhe trupave këshillëdhënëse të njëjësive simotra.

Objektivi specifik 2.3 – Krijimi i grupeve me pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë

Arritja e këtij objektivi fillon me identifikimin e kërkesave të ekonomisë, tregtisë dhe industrisë, me qëllim të përafrimit të programeve të studimit konform kërkesave të tregut të punës. Ky objektivi parasheh shtimin e projekteve kërkimore për 10% më shumë projekte. Ndërlidhja me nevojën e tregut të punës vendor dhe ndërkombëtar parasheh edhe rritjen e financimit nga sektori privat përmes shërbimeve të ofruara dhe ndërmjetësuar nga universiteti. Të arriturat e projekteve do të publikohen në revistat të indeksuara shkencore. PSFA synon rritjen e numrit të publikimeve në top revista shkencore për 10% më shumë publikime.

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.3 – Krijimi i grupeve me pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Publikime në revista shkencore cilësore	10% më shumë publikime
Projekte kërkimore-shkencore, akademike dhe profesionale	10% më shumë projekte
Rritja e financimit nga sektori publik, privat, donacionet apo të hyrat vetanake nga IKAU dhe QNLT	25% rritje e fondeve
Veprimet e planifikuara	
2.3.1	Identifikimi i kërkesave të ekonomisë dhe industrisë së vendit dhe përafrimi me përditësimin e programeve studimore

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.3 – Krijimi i grupeve me pjesëmarrës vendorë e ndërkombëtarë

2.3.2	Krijimi i grupeve me fokus nga ekonomia të udhëhequra nga personeli i FA, duke shfrytëzuar IKAU-në dhe QNLT-në e FA
2.3.3	Formimi i grupeve duke përfshirë edhe studente të nivelit MSc dhe PhD ndërkombëtar në përgatitjen e projekteve, prototipave dhe modeleve/simulimeve.
2.3.4	Të arriturat e projekteve kërkimore të publikohen në revistat të indeksuara me target shkencor
2.3.5	Implementimi i rezultateve dalëse dhe nevoja për përditësime dhe adaptime pas aplikimit

Objektivi specifik 2.4 – Avancimi i Institutit për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm

Përmes projekteve si *Horizon Europe* dhe të ngjashëm, Plani Strategjik FA synon krijimin e një grupi të përbashkët ndërkombëtar për nismën dhe avancimin e ndikimit të studiuesve vendor në zhvillimin global. Kjo qasje nënkupton krijimin e kontakteve të IKAU-të me universitete ndërkombëtare me qëllim të krijimit të koncursimeve për aplikim të përbashkët në projekte ndërkombëtare. Suksesi i zbatimit të këtij objekti do të matej duke rritur numrin e aplikimeve në projekte ndërkombëtare për të paktën 3 aplikime në vit si dhe duke rritur numrin e kërkimeve të përbashkëta shkencore në të paktën 1 kërkim në vit.

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.4 – Avancimi i Institutit për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Numri i projekteve vendore dhe ndërkombëtare të financuara	Të paktën 3 aplikime në vit
Studime/publikime të përbashkëta shkencore	Të paktën 1 kërkim në vit
Numri i aplikimeve ndërkombëtare	Të paktën 1 aplikim në vit
Veprimet e planifikuara	
2.4.1	Kërkimi i kërkesave dhe afateve për aplikim në projekte ndërkombëtare bazuar në analizën e mundësive në projekte që lidhen me fushat specialiste të arkitekturës dhe urbanizmit
2.4.2	Kontakti me personat të zyrës së projekteve të fakulteteve simotra ndërkombëtare për pjesëmarrje në koncursime të përbashkëta
2.4.3	Përcjellja e afateve për plotësim të dokumentacionit nga FA në bashkëpunim me zyrën e projekteve në kuadër të UP

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.4 – Avancimi i Institutit për Kërkime në Arkitekturë dhe Urbanizëm

2.4.4	Përfitimet e njohurive dhe përvojave nga aplikimet e ngjashme me fakultetet simotra ndërkombëtare
2.4.5	Krijimi i buxhetit të qëndrueshëm nga të hyrat e bizneseve dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe institucionet publiko-private

Objektivi specifik 2.5 – Krijimi i Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji në AU

Përmes projekteve si *Horizon Europe* dhe të ngjashëm edhe në nivelin vendor, avancimi i shkencës dhe novacionit, eksperimentimit laboratorik dhe teknologjik në FA e më gjerë, PSFA synon institucionalizimin e infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimin e Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji (QNL), të përcjellë me ndërtesë e pajisje të reja për të mbështetur kërkimin-shkencor, akademik dhe profesional. Kjo nënkupton rritjen e buxhetit për zhvillimin e infrastrukturës urb-arkitektonike, digjitale, rritjes së qasjes në databaza të ndryshme ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve të drejtpërdrejta në salla mësimore, bibliotekë dhe laboratorë për zhvillimin e kërkimeve shkencore.

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.5 – Krijimi i Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji (QNL)

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Zhvillimi i infrastrukturës arkitektonike	Rritja e buxhetit për këtë qëllim, konform strategjisë dhe rregulloreve të UP
Zhvillimi i infrastrukturës digjitale	Rritja e buxhetit për këtë qëllim, konform strategjisë dhe rregulloreve të UP
Qasje në databaza të ndryshme ndërkombëtare	Rritja e buxhetit për këtë qëllim, konform strategjisë dhe rregulloreve të UP
Investime në laboratorë/ndërtesa për zhvillimin e novacioneve dhe eksperimenteve teknologjike	Rritja e buxhetit për këtë qëllim, konform strategjisë dhe rregulloreve të UP
Investime në salla dhe ndërtesë	Rritja e numrit të sallave, ndërtesë e veçantë, konform strategjisë dhe rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	
2.5.1	Hulumtimi i kërkesave të tregut dhe përshtatja me infrastrukturën ekzistuese për IKAU dhe QNL

Objektivi Strategjik 2 – Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe Shërbimi për shoqërinë e vendin

Objektivi specifik 2.5 – Krijimi i Qendrës për Novacion, Laborator dhe Teknologji (QNLT)

2.5.2	Krijimi i hapësirave të reja për IKAU dhe QNLT, për fushat specialitike të arkitekturës dhe urbanizmit
2.5.3	Ftesa dhe ofrimi i hapësirave për kompanitë për zhvillimin e produkteve në kuadër të IKAU dhe QNLT
2.5.4	Realizimi i bashkëpunimeve në rritjen e ndërtesave dhe infrastrukturës të reja për qasje novatore
2.5.5	Krijimi i buxhetit të qëndrueshëm nga të hyrat e bizneseve dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe institucionet publiko-private

Objektivi strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve

Objektivi i tretë strategjik synon përmirësimin e dukshëm të pozitës dhe rolit të FA në skenën vendore dhe ndërkombëtare. Kjo synohet të arrihet përmes rritjes së numrit dhe mundësive të studimit dhe kërkimit në FA për studentët dhe studiuesit ndërkombëtar, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe profesional, përmirësimit të brendit të FA në rangimin botëror, zgjerimit të mundësive për studentët dhe hulumtuesit e FA për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit, si dhe përmes rritjes së njohurive ndërkulturore.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3	Suksesi dhe Mbështetja e studentëve
OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1	Rishikimi i numrit të studentëve në programet studimore
OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2	Mobiliteti i studentëve me performancë të lartë
OBJEKTIVI SPECIFIK 3.3	Sigurimi i teknologjisë informative për studentët
OBJEKTIVI SPECIFIK 3.4	Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore për studentët

Objektivi specifik 3.1 – Rishikimi i numrit të studentëve në programet studimore

Përmirësimi i pozitës së FA në skenën ndërkombëtare përmes rishikimit të numrit të studentëve do të fillojë nga rritja e mundësive për studentë dhe hulumtues shkencorë ndërkombëtarë krahas studentëve vendorë. Konkretisht, brenda katër viteve, PSFA synon të rrisë numrin e studentëve ndërkombëtarë prej 5% nga numri aktual, kurse numrin e profesorëve ndërkombëtarë ta rrisë për 2%. Si tregues matës do të përdoret edhe

numri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare si dhe i kërkimeve shkencore të përbashkëta me universitetet tjera, ku synohet që ky numër të rritet për 5%. Veprimet e planifikuara në kuadër të këtij objekti strategjik janë ofrimi i bursave dhe paketave ndihmëse financiare, ofrimi i kurseve në gjuhë të huaja dhe i diplomave të dyfishta në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare. Këto veprime pritet të bazohen në një strategji të re të publicitetit.

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.1 – Rishikimi i numrit të studentëve në programet studimore	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Numri i studentëve ndërkombëtarë	5% rritje nga trendi aktual
Numri i profesorëve ndërkombëtarë	2% rritje nga trendi aktual
Pjesëmarrja në projektet ndërkombëtare	5% rritje nga trendi aktual
Kërkime shkencore të përbashkëta me universitete të tjera	5% rritje nga trendi aktual
Veprimet e planifikuara	
3.1.1	Strategji të synuara publiciteti dhe rekrutimi, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
3.1.2	Ofrimi i bursave konkurruese dhe paketa ndihme financiare, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
3.1.3	Ofrimi i kurseve dhe programeve akademike në gjuhë të huaj/diploma të përbashkëta, dhe diploma të dyfishta, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
3.1.4	Zhvillimi i databazës funksionale për shërbimet e ndërkombëtarizimit të UP
3.1.5	Krijimi i partneritetit me agjenci dhe institucione ndërkombëtare përmes UP

Objektivi specifik 3.2 – Mobiliteti i studentëve me performancë të lartë

Krijimi i partneriteteve me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare, përkrahja e personelit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve, do të kontribuojnë në përmirësimin e pozitës së FA në skenën ndërkombëtare. Përmirësimi i pjesëmarrjes në programe të bashkëpunimit akademik dhe shkencor po ashtu do të rezultojë në rritjen e numrit të botimeve të përbashkëta, rritjen e programeve të shkëmbimit, rrjedhimisht në rritjen e numrit të studentëve me performancë të lartë që shkojnë për një semestër jashtë vendit.

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.2 – Mobiliteti i studentëve me performancë të lartë	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Numri i aplikimeve grupore	5% rritje nga trendi aktual
Numri i aplikimeve individuale	5% rritje nga trendi aktual
Numri i studentëve që shkojnë për një semestër jashtë vendit	10% rritje nga trendi aktual
Numri i programeve të shkëmbimit	5% rritje nga trendi aktual
Numri i botimeve të përbashkëta nga mobilitetet	5% rritje nga trendi aktual
Veprimet e planifikuara	
3.2.1	Rritja e partneriteteve me universitete dhe institucione kërkimore kryesore ndërkombëtare
3.2.2	Nxitja dhe përkrahja e personelit akademik për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare që mbështesin programe mobiliteti
3.2.3	Zhvillimi i kapaciteteve të FA për ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve
3.2.4	Përfshirja e diasporës në kërkime dhe programe mobiliteti
3.2.5	Nxitja dhe përkrahja e studentëve dhe personelit akademik për botime të përbashkëta nga mobilitetet e studentëve.

Objektivi specifik 3.3 – Sigurimi i teknologjisë informative për studentët

Mbështetur në Planin Strategjik të UP, Strategjia parasheh disa veprime konkrete për të përmirësuar brendin në katër vitet e ardhshme. PSFA synon të arrihen katër marrëveshje të reja partneriteti me universitete të tjera. Tregues matës i këtij objekti do të jetë ngritja e rangimit UP në *Webometrics* dhe *New Times Higher Education* e ndihmuar edhe nga FA. Përmes krijimit të një plani të publicitetit në mediat sociale dhe marketingut, FA do të rrisë prezencën dhe shkëmbin e platformave. Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve dhe personelit akademik ndërkombëtar do të ndikojnë direkt në rritjen e njohjes dhe vlerësimit të FA në skenën ndërkombëtare dhe vendore.

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.3 – Sigurimi i teknologjisë informative për studentët	
Treguesit	Vlera e synuar 2028

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.3 – Sigurimi i teknologjisë informative për studentët	
Numri i pajisjeve TI në dispozicion	25% rritje nga trendi aktual
Ligjëratat dhe detyrat online	25% rritje nga trendi aktual, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Sistemi anti-plagjiat	Konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Ruajtja digjitale e të dhënave	Përdorimi i <i>icloud</i> për ruajtje
Trajnime për përdorimin e pajisjeve digjitale	Më së paku 2 trajnime në vit
Veprimet e planifikuara	
3.3.1	Plotësimi i potencialin të TI nga fondet e IKAU dhe QNLT
3.3.2	Ridizajnimi dhe ri strukturimi i platformës digjitale (ueb faqes, mediave sociale, e të tjera)
3.3.3	Promovimi i arritjeve dhe renditjeve ndërkombëtare të platformave të mediave digjitale dhe sociale
3.3.4	Sigurimi i të hyrave nga projektet kërkimore-shkencore dhe akademike nga IKAU
3.3.5	Sigurimi i të hyrave nga projektet kërkimore-shkencore dhe akademike nga QNLT

Objektivi specifik 3.4 – Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore për studentët

Rritja e kompetencës ndërkulturore synohet të arrihet duke shtuar numrin e ngjarjeve ndërkulturore që kanë për qëllim studentët, si dhe duke shtuar numrin e trajnimeve për personelin akademik. Ndër veprimet tjera që parashihen janë edhe rritja e novacioneve në organizimin dhe përmbajtjen e UVP-së dhe javës ndërkombëtare dhe integrimin e çështjeve dhe perspektivave globale në kurrikulë. Treguesit për matjen e këtij objektivi do të jenë edhe rritja e numrit të studentëve të huaj që do studiojnë për një semestër në FA.

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.4 – Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore për studentët	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore që kanë për qëllim studentët	1 ngjarje në vit
Numri i trajnimeve për personelin për rritjen e njohurive ndërkulturore	2 ngjarje në vit

Objektivi Strategjik 3 – Suksesi dhe Mbështetja e studentëve	
Objektivi specifik 3.4 – Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore për studentët	
Numri i studentëve të huaj	2% rritje nga trendi aktual
Numri i lëndëve inovative në kurrikulë studimore	15% rritje nga numri i tanishëm
Veprimet e planifikuara	
3.4.1	Krijimi i këndeve ndërkombëtare udhëhequr nga UP
3.4.2	Organizimin e ngjarjeve kulturore ndërkombëtare
3.4.3	Novacion në organizimin dhe përmbajtjen e UVP-së dhe javës ndërkombëtare të UP ku përfshihet edhe FA
3.4.4	Integrimin e çështjeve dhe perspektivave globale në kurrikulë

Objektivi strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare

Objektivi i katërt i Planit Strategjik FA synon angazhimin dhe shtrirjen vendore e ndërkombëtare përmes rritjes së bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare dhe vendore, nxitjen e pjesëmarrjes në programet kombëtare të bashkëpunimit për të ofruar ekspertizën akademike, shkencore dhe profesionale. PSFA synon që të nxisë, rrisë dhe përkrahë personelin akademik në forcimin e kapaciteteve për angazhim në kërkim të fondeve vendore dhe ndërkombëtare.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4	Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1	Rritja e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.2	Rritja e bashkëpunimeve me institucionet vendore
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.3	Pjesëmarrja në forumet shkencore vendore dhe ndërkombëtare
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.4	Promovimi i materialeve reciproke në nivel akademik dhe praktik
OBJEKTIVI SPECIFIK 4.5	Promovimi i integritetit akademik

Objektivi specifik 4.1 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare

Përmirësimi i pozitës së FA në skenën ndërkombëtare do të vazhdohet duke rritur numrin e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare, krijim të ngjarjeve për rrjetëzim, shkëmbim të programeve studimore dhe organizim të konferenca e ekspozita ndërkombëtare. PSFA planifikon përmirësimin e proceseve administrative për të lehtësuar procesin e organizimit të takimeve për rrjetëzim dhe implementim dhe monitorim transparent të bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Objektivi Strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare	
Objektivi specifik 4.1 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Bashkëpunimi me universitete të tjera	2 marrëveshje në vit
Krijimi i ngjarjeve për rrjetëzim	2 punëtori në vit në kuadër të IPAU
Shkëmbim të programeve studimore	2 fakultete ndërkombëtare që referohen në programin studimor
Konferenca ndërkombëtare	1 konferencë e hapur ndërkombëtare çdo dy vjet dhe 1 konferencë tematike në çdo 2 vjet.
Ekspozita dhe konkurse ndërkombëtare	Konkurse, çmime dhe ekspozita të hapura tematike nga fushat e specializimit të arkitektures
Veprimet e planifikuara	
4.1.1	Krijimi i bashkëpunimeve të FA konform Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
4.1.2	Përmirësimi i proceseve administrative për të lehtësuar procesin e organizimit të takimeve për rrjetëzim
4.1.3	Zhvillimi i partneriteteve me fakultetet ndërkombëtare në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit me anë të programeve të shkëmbimit dhe bursave të studimit.
4.1.4	Rritje të pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare
4.1.5	Rishikimi dhe përshtatja e Planit Strategjik të Fakultetit të Arkitekturës (PSFA) 2024-2028 me Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës 2023-2025 për rritjen e bashkëpunimeve me institucionet akademike ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.2 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet vendore

Arritja e këtij objekti do të bëhet përmes veprimeve konkrete për të rritur numrin e bashkëpunimeve me institucione vendore. PSFA synon krijimin e ngjarjeve që nxisin bashkëpunim me institucionet vendore përmes Trupës Këshillëdhënëse të FA, shkëmbimin e materialeve promovuese në tregun e punës dhe përfshirje të

bashkëpunëtorëve vendor në konferenca ndërkombëtare dhe ekspozita të IPAU. Në kuadër të IPAU synohet të shpalosen edhe rezultatet e aktivitetit kërkimor-shkencor, akademik dhe profesional të IKAU dhe QNLT të FA.

Objektivi Strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare	
Objektivi specifik 4.2 – Rritja e bashkëpunimeve me institucionet vendore	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Bashkëpunimi me institucione vendore	5 marrëveshje në vit
Krijimi i ngjarjeve për rrjetëzim	2 punëtori me Trupën Këshillëdhënëse të FA
Shkëmbim të materialeve promovuese	5 promovime në vit
Konferenca ndërkombëtare	4 bashkëpunëtorë vendorë në konferencë të hapur ndërkombëtare dhe 4 të tjerë në konferencën tematike
Ekspozita/promovim kurrikular	2 ekspozita promovuese nga fushat e specializimit
Veprimet e planifikuara	
4.2.1	Krijimi i bashkëpunimeve të FA konform Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
4.2.2	Përmirësimi i proceseve administrative për të lehtësuar takimet me institucionet vendore
4.2.3	Implementimi dhe monitorimi transparent i bashkëpunimeve vendore
4.2.4	Rritje të pjesëmarrjes së institucioneve vendore në IPAU
4.2.5	Rishikimi i kurrikulës për punën praktike të studentëve në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore

Objektivi specifik 4.3 – Pjesëmarrja në forumet shkencore vendore dhe ndërkombëtare

Përmes këtij objektivi synohet kërkimi dhe sigurimin e mundësive të reja për pjesëmarrje në forume shkencore vendore dhe ndërkombëtare që mundëson rritja e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe studentëve në forumet shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Veprimet e planifikuara nën këtë objektivi specifik janë krijimi i grupeve të përbashkëta kërkimore shkencore me universitetet tjera, tendenca për krijimin e PhD së përbashkët sipas marrëveshjeve me universitetet tjera ndërkombëtare, aplikim të drejtpërdrejtë të rezultateve dalëse kërkimore në ekonominë dhe industrinë, rritja të bashkëpunimit që mbështet kërkesat e tregut vendor dhe ndërkombëtarë përmes adaptimit dhe/ose përshtatjes së programeve studimore konform kërkesave të ekonomikes, tregut dhe industrisë.

Objektivi Strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.3 – Pjesëmarrja në forumet shkencore vendore dhe ndërkombëtare

Treguesit		Vlera e synuar 2028
Pjesëmarrja në konferenca, seminare, etj. ndërkombëtare e personelit akademik		50% e personelit akademik në një forum për vit
Pjesëmarrja në konferenca, seminare, tryeza, punëtori, etj. vendore të studentëve		10% e studentëve në një forum për vit
Pjesëmarrja në konferenca, seminare, etj. vendore të personelit akademik		50% e personelit akademik në një forum për vit
Pjesëmarrja në konferenca, seminare, tryeza, punëtori, etj. vendore e studentëve		10% e studentëve në një forum për vit
Nxitja e personelit dhe studentëve për pjesëmarrje në forume shkencore		100% e personelit akademik dhe studentëve janë pjesëmarrës së paku në një forum shkencor/profesional për vit
Veprimet e planifikuara		
4.3.1	Krijimi i grupeve të përbashkëta hulumtuese shkencore me Universitetet tjera ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të platformave për aplikim në programe/grande Evropiane (si <i>Horizon Europe</i> etj.)	
4.3.2	Tendenca për krijimin e PhD të përbashkëta sipas marrëveshjeve me universitetet tjera ndërkombëtare dhe targetimit për Diplomë e dyfishtë PhD në fushën e FA	
4.3.3	Lidhja e rezultateve shkencore me ekonominë dhe aplikimi i drejtpërdrejtë në industri	
4.3.4	Zhvillimi i kërkesave për kërkime shkencore duke përmirësuar infrastrukturën ekzistuese me fokus në laboratorë dhe hapësira përcjellëse me qëllim të arritjes së synimeve të ekuivalentimit me fakultetet tjera simotra.	
4.3.5	Rritja e bashkëpunimit me kërkesat e tregut vendor dhe ndërkombëtarë përmes adaptimit/përshtatjes së programeve ekzistuese të studimeve dhe tendenca për programe të reja konform kërkesave të tregut të lirë të punës.	

Objektivi specifik 4.4 – Promovimi i materialeve reciproke në nivel akademik dhe praktik

Ky objektivi specifik ka për synim nxitjen e numrit të numrit të pajisjeve të TI për studentët dhe punën në grupe, mundësimin e ligjëratave *online*, mundësinë e dorëzimit të detyrave dhe punimeve *online*, përdorimin e sistemit anti-plagjiat, ruajtjen digjitale të punimeve dhe detyrave si dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe të studentëve për zhvillimin e njohurive të tyre digjitale.

Objektivi Strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.4 – Promovimi i materialeve reciproke në nivel akademik dhe praktik

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Rritja e promovime akademike, shkencore praktike të përbashkëta	5 takime sipas fushës specialistike në vit
Publikimi dhe shpalosja e materialeve të përbashkëta	15% të ligjëratave integrojnë publikimin dhe shpalosjen reciproke të materialeve akademike apo/dhe praktike
Integrimi i njohurive praktike në kurrikulat akademike	10% të kurrikulës adaptohet në punë praktike
Njohja dhe përvetësimi profesional dhe praktik	20% e programit studimore preferohet të praktikohet
Veprimet e planifikuara	
4.4.1	Krijimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të brendit dhe marketingut me qëllim të promovimit të identitetit akademik e institucional për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata me studentët, personelin akademik, donatorët dhe komunitetin në përgjithësi, e në veçanti të arkitektëve dhe urbanistëve.
4.4.2	Rekrutimi i zyrtarit për komunikimin me publikun për promovim të materialeve
4.4.3	Ridizajnimi dhe ristrukturimi i platformës digjitale (ueb faqes, media sociale, e të tjera)
4.4.4	Krijimi i planit afatmesëm për publikimit/diseminimin e programeve studimore me qëllim të planifikimit të praktikës profesionale.
4.4.5	Promovimi i programit të studimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e studentëve dhe punëdhënësve

Objektivi specifik 4.5 – Promovimi i integritetit akademik

Ndër veprimet që parashihen me këtë objektivi janë njohja dhe vlerësimi i integritetit akademik të personelit akademik midis institucioneve ndërkombëtare arsimore. PSFA synon një përpjekje të përbashkët për të mbështetur standardet etike në kontekste të ndryshme kulturore. Këtu janë pesë tregues për të sinjalizuar promovimin e integritetit akademik midis institucioneve arsimore ndërkombëtare. Synohet implementimi i një sistemi efikas që përcjell, raporton dhe monitoron rastet e sjelljes jo adekuate akademike dhe promovim të udhëzuesëve të qartë për masat mbrojtëse për sinjalizuesit. PSFA synon rritjen dhe nxitjen e promovimit të integritetit të akademik, konform PSUP dhe rregulloreve të UP-së.

Objektivi Strategjik 4 – Angazhimi dhe Shtrirja vendore e ndërkombëtare

Objektivi specifik 4.5 – Promovimi i integritetit akademik

Treguesit	Vlera e synuar 2028
Efikasiteti i sistemit të raportimit dhe monitorimit	Koha për zgjidhjen e incidenteve apo shkeljeve akademike brenda dy jave, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Efikasiteti i qasjes dhe përdorimit të sistemit të raportimit.	Komentet/ vlerësimet e përdorueseve, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Punonjësit e rinj njoftohen me rregullat dhe parimet	95% të stafit të ri njoftohen me rregullat e nevojshme, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Trajnime të domosdoshme	Rritja e numrit të stafit dhe studentëve që kanë ndjekur trajnimet e domosdoshme, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Shërbimet e angazhimit dhe mbështetjes në komunitet	Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse mbështetëse dhe nxitja e promovimit të integritetit akademik, konform Strategjisë dhe Rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	
4.5.1	Implementimi i një sistemi efikas të përcjelljes dhe raportimit për të monitoruar dhe analizuar rastet e sjelljes së pahijshme akademike (një platformë të lehtë përdorshme dhe konfidenciale të raportimit), dhe zhvillimi dhe promovimi i udhëzuesve të qartë për masat mbrojtëse për sinjalizuesit.
4.5.2	Krijimi i kampanjave të targetuara për të ngritë vetëdijesimin dhe parandaluar rastet specifike të sjelljes së pahijshme akademike (plagjiaturën, ngacmimin seksual dhe ngacmimin tjetër, mashtrimin etj.).
4.5.3	Krijimi dhe shpërndarja e anketimeve vjetore për të vlerësuar njohuritë, përputhshmërinë dhe klimën etike brenda FA dhe UP.
4.5.4	Ofrimi i trajnimeve të rregullta të detyrueshme për stafin akademik, administrativ dhe studentët, përfshirë zhvillimin e burimeve atraktive edukuese <i>online</i> siç janë kurset, udhëzimet <i>online</i> për të promovuar sjelljen etike.
4.5.5	Fuqizimi i mëtutjeshëm i Këshillit të Etikës për të hetuar dhe zgjidhë rastet e sjelljes së pahijshme akademike dhe krijimi i një ekipi të dedikuar për t'i asistuar sinjalizuesit gjatë tërë procesit të raportimit, konform PSUP

Objektivi strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet

Objektivi i pestë i PSFA synon zhvillimin e infrastrukturës arkitektonike dhe digjitale për të fuqizuar qeverisjen, integritetin financiar dhe burimet. Kjo synohet të arrihet përmes planifikimit, projektimit, implementimit dhe digjitalizimit të ndërtesave të FA; dhe promovimit, menaxhimit dhe komercialimi të pronësisë akademike në kuadër të strukturës organizative me transparencë dhe llogaridhënie.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5	Infrastruktura dhe Burimet
OBJEKTIVI SPECIFIK 5.1	Planifikimi i kampusit të FA
OBJEKTIVI SPECIFIK 5.2	Zhvillimi i projekteve kërkimore-shkencore, akademike dhe profesionale
OBJEKTIVI SPECIFIK 5.3	Përmirësimi dhe digjitalizimi i infrastrukturës së FA
OBJEKTIVI SPECIFIK 5.4	Promovimi, menaxhimi dhe komercialimi i pronësisë akademike
OBJEKTIVI SPECIFIK 5.5	Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies

Objektivi specifik 5.1 – Planifikimi i kampusit të FA

Ky objektivi specifik synon të nxisë përdorimin e potencialit hapësinor arkitektonike dhe urban që ka kampusi i FA e që aktualisht ofron komfort minimal për shfrytëzuesit. Brenda këtij objektivi specifik synohet të bëhet rishikimi dhe azhurnimi i saktësisë së të dhënave të menaxhimit të aseteve, përfshirë verifikimin dhe përditësimin e të dhënave relevante dhe pronësisë që shfrytëzon FA e UP, përfshirë të gjitha ndërtesat në kuadër të kampusit të FA. Synohet krijimi i një platforme digjitale, lehtësisht të përdorshme për menaxhimin e aseteve të luajtshme të FA. Ndër treguesit objektivë janë hartimi i planifikimit dhe i planeve për zhvillim infrastrukturor.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet	
Objektivi specifik 5.1 – Planifikimi i kampusit të FA	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Incizimi kadastral dhe definimi i kufijve të pronës/kampusit në shfrytëzim	Posedimi i certifikatës së shfrytëzimit të pronës

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet

Objektivi specifik 5.1 – Planifikimi i kampusit të FA

Rehabilitimi urb-arkitektonik i kampusit	Implementimi i rregullimit të jashtëm të kampusit me sipërfaqe totale ~7549m ² , pas zgjerimit të planifikuar me ndërtesat ekzistuese me shputë ~1600m ² , duke shtuar shputat e reja të propozuara të anekseve 1 dhe 2 me sipërfaqe ~800m ²
Planifikimi i ndërtesave të kampusit	Krahas ndërtesave ekzistuese me sipërfaqe totale 2734 m ² shtohen ndërtesat e reja: Aneksi 1 me sipërfaqe ~1000m ² dhe Aneksi 2 me sipërfaqe ~4500m ²
Projektimi arkitektonik i ndërtesave kampusit	Hartimi i projektit ideor dhe zbatues për ndërtimin e Aneksit 1 (biblioteka, laborator, etj.) dhe Aneksit 2 (salla mësimi, amfiteatër, hapësira për IKAU, QNLT, etj.)
Realizimi i zhvillimit infrastrukturor të ndërtesave ekzistuese me anekse	Implementimi i projektit zbatues për ndërtimin e Aneksit 1 (biblioteka, laborator, etj.) dhe Aneksit 2 (salla mësimi, amfiteatër, hapësira për IKAU, QNLT, etj.)

Veprimet e planifikuara

5.1.1	Zhvillimi dhe implementimi të procesit të standardizuar për marrjen e pëlqimit në Komunën e Prishtinës për zhvillim e infrastrukturës arkitektonike të kampusit të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.1.2	Zhvillimi i procesit të hartimit të projektit ideor për zhvillim e infrastrukturës arkitektonike të kampusit të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.1.3	Zhvillimi i procesit të hartimit të projektit kryesor për zhvillim e infrastrukturës arkitektonike të kampusit të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.1.4	Zhvillimi i procesit të hartimit të projektit për realizimin e zhvillimit të infrastrukturës arkitektonike të kampusit të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.1.5	Implementimi i projektit për realizimin e zhvillimit të infrastrukturës arkitektonike të FA realizimin e ndërtesave shtesë Aneksi 1 dhe Aneksi 2 në kuadër të kampusit të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP

Objektivi specifik 5.2 – Zhvillimi i projekteve kërkimore-shkencore, akademike dhe profesionale

Ky objektivi synon ta rrisë efikasitetin e sistemit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimit shkencor, akademik, novativ, laboratorik, teknologjik dhe profesional në kuadër të IKAU dhe QNLT, konform Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP. Ndër veprimet konkrete parashihet edhe krijimi i kampanjave të targetuara për të nxitur potencialin e donatorëve, krahas fondeve publike, të hyrave nga sektori privat apo të ardhurat vetanake të FA të gjeneruara nga zhvillimi i projekteve. PSFA synon rritjen e të hyrave në Euro, nga sektori

publik, privat apo nga të ardhurat vetanake të IKAU dhe QNLT për funksionalizimin e ndërtesave të reja – anekseve 1 dhe 2 në kuadër të kampusit të FA.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet	
Objektivi specifik 5.2 – Zhvillimi i projekteve kërkimore-shkencore, akademike e profesionale	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Operacionalizimi institucional i IKAU dhe QNLT	Institucionalizimi i IKAU dhe QNLT konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Operacionalizimi arkitektonik i IKAU dhe QNLT	Rritja e sipërfaqes së ndërtesave të kampit të FA për IKAU dhe QNLT konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Operacionalizimi i sistemeve dhe pajisjeve të IKAU dhe QNLT	Rritja e të hyrave në Euro, nga sektori publik, privat apo të ardhurat vetanake të IKAU dhe QNLT për funksionalizimin e Aneksit 1 dhe Aneksit 2, konform Statutit, Strategjisë dhe Rregulloreve të UP.
Nxitja për projekte kërkimore-shkencore, akademike dhe profesionale	Rritja e të hyrave në Euro, nga sektori publik, privat apo të ardhurat vetanake të IKAU dhe QNLT
Veprimet e planifikuara	
5.2.1	Zhvillimi dhe implementimi i procesit të standardizuar për marrjen e lejes për funksionalizimin e IKAU, respektivisht iniciimin dhe funksionalizimin e QNLT, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.2.2	Zhvillimi i procesit të hartimit të projektit ideor të enterierit për IKAU dhe QNLT të FA, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.2.3	Blerja, transporti dhe instalimi i paisjeve në hapëriat e IKAU dhe QNLT, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.2.4	Marrja e lincencimit për aktivitetet në IKAU dhe QNLT nga organet kompetente, përfshirë procedurat e nevojshme në kuadër të UP
5.2.5	Rritja e projekteve kërkimore shkencore dhe inventive të FA

Objektivi specifik 5.3 – Përmirësimi dhe digjitalizimi i infrastrukturës së FA

Ky objektivi do të arrihet përmes digjitalizimit të shërbimeve administrative të UP, digjitalizimit të shërbimeve mësimore, përmirësimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore, zhvillimit të njohurive digjitale të stafit dhe studentëve, dhe përmes azhurnimit të politikave dhe proceseve për digjitalizim. TI për studentët dhe punën në grupe, mundësimin e ligjëratave *online*, mundësinë e dorëzimit të

detyrave dhe punimeve *online*, përdorimin e sistemit anti-plagjiat, ruajtjen digjitale të punimeve, detyrave si projekteve kërkimore-shkencore dhe profesionale. Po ashtu parashikon trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe të studentëve për zhvillimin e njohurive të tyre digjitale.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet	
Objektivi specifik 5.3 – Përmirësimi dhe digjitalizimi i infrastrukturës së FA	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Digjitalizimi i shërbimeve mësimore dhe administrative	Konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Përmirësimi i TI dhe komunikimit brenda sallave mësimore dhe bibliotekës	Konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Përmirësimi i TI dhe komunikimit brenda IKAU dhe QNLT	Përmirësimi dhe rritja e TI për IKAU dhe QNLT, nga sektori publik, privat, të ardhurat vetanake, konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Zhvillimi i njohurive digjitale të stafit dhe studentëve	Konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Përmirësimi i standardeve të sigurisë dhe privatësisë së të dhënave dhe pronësisë intelektuale	Konform Statutit, Planit Strategjik dhe Rregulloreve të UP
Veprimet e planifikuara	
5.3.1	Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të ngritjes së fondeve për të identifikuar nevojat për TI të FA, përfshirë donacionet, sponsorizimet dhe entitetet publike dhe private
5.3.2	Lidhja e partneriteteve me industrinë dhe sektorin privat për kërkime të përbashkëta, projekte novative dhe iniciativa tjera të cilat gjenerojnë të hyra për TI dhe pajisjet tjera të IKAKU dhe QNLT
5.3.3	Zhvillimi dhe implementimi i standardit digjital për mësim i cili përcakton nivelin obligator të integritetit të teknologjive në klasa, zhvillimin e programeve dhe përmbajtjes online, dhe përdorimit të teknologjive për mësim, në IKAU dhe QNLT
5.3.4	Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve, programeve të trajnimit dhe produkteve tjera edukative <i>online</i> për licencim dhe shitje për të gjeneruar të hyra shtesë për FA, rrjedhimisht për UP
5.3.5	Lansimi i një programi promovues dhe marketingut të projekteve aplikative të FA

Objektivi specifik 5.4 – Promovimi, menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë akademike

Përmes këtij objektivi synohet promovimi, menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë akademike; kërkohet përmirësimi i standardeve të sigurisë si dhe privatësisë së të dhënave. Objektivi parasheh edhe pajisjen e

sallave me kamera dhe zërim, pajisjen e sallave të takimeve me teknologji të komunikimit si dhe trajnimin e personelit për përdorim të teknologjisë moderne. Rritja e fondeve publike për universitetin, rritja e të hyrave nga sektori privat, si dhe rritja e të hyrave të tjera sikurse nga licencimet dhe trajnimet. Veprimet e parapara nën këtë objektiv janë zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të ngritjes së fondeve për të identifikuar burimet e mundshme të financimit siç janë grantet, donacionet, sponsorizimet, dhe entitetet publike dhe private dhe krijimi i një ekipi përgjegjës për kërkimin dhe sigurimin e mundësive të reja për financimin e Universitetit. Po ashtu synohet rishikimi i rregullt dhe vlerësimi i rezultateve kërkimore, akademike dhe profesionale për të identifikuar asetet e mundshme të pronësisë akademike si dhe mbrojtjen e duhur të aseteve të pronësisë akademike përfshirë regjistrimet e projekteve dhe produkteve tjera në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit, duke parashikuar mbrojtjen me të drejtën e autorit etj. Ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për personelin akademik të fakultetit konform PSUP dhe legjislacionit për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet	
Objektivi specifik 5.4 – Promovimi, menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë akademike	
Treguesit	Vlera e synuar 2028
Sistemi i duhur është në funksion	Zyra për pronën intelektuale është themeluar dhe është funksionale në kuadër të UP
Numri i personelit është trajnuar dhe angazhuar	Të trajnohen 2 anëtarë të personelit akademik
Numri i projekteve kërkimore-shkencore, akademike e profesionale, dhe formave të tjera të pronësisë intelektuale.	15 për tri vite
% e të hyrave të mbledhura nga licencimi dhe komercializimi i pronësisë intelektuale	50% rritje për tri vite
Veprimet e planifikuara	
5.4.1	Konform themelimit dhe menaxhimit të Zyrës për Pronësi Intelektuale brenda universitetit me personel të trajnuar për zhvillimin e politikave, rishikimi i rregullt dhe vlerësimin e rezultateve kërkimore për të identifikuar asetet e mundshme të pronësisë intelektuale.
5.4.2	Konform mbrojtjes së duhur të aseteve dhe të pronësisë intelektuale përfshirë regjistrimet e projekteve, brendeve, mbrojtjen me të drejtën e autorit etj., ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për komunitetin e FA në kuadër të UP për mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale.
5.4.3	Komercializimi i aseteve të pronësisë intelektuale përmes projekteve për ekonominë, tregtinë dhe industrinë, zyra për transferim të teknologjisë, inkubatorë biznesi, zhvillimi i strategjive të licencimit për kurse dhe trajnime online dhe produkte tjera të FA në kuadër të UP.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet

Objektivi specifik 5.4 – Promovimi, menaxhimi dhe komercalizimi i pronësisë akademike

5.4.4	Zhvillimi dhe shitja e produkteve / projekteve që përmbajnë logon e universitetit sipas strategjisë gjithëpërfshirëse për ngritjen e fondeve të FA, rrjedhimisht të universitetit.
5.4.5	Vlerësimi i rregullt i performancës të portfolios së pronësisë intelektuale, përfshirë të hyrat e gjeneruara nga licencimimi, komercializimi dhe identifikimi i fushave për përmirësim.

Objektivi specifik 5.5 – Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies

Ky objektivi specifik është referuar objektivit 5 të PSUP dhe synon menaxhimin brenda FA të strukturës organizative dhe transparencës për krijimtarinë dhe veprimtarinë kërkimore shkencore akademike dhe profesionale të komunitetit të fakultetit duke u bazuar PSFA, konform statutit, rregulloreve dhe PSUP.

Objektivi Strategjik 5 – Infrastruktura dhe Burimet

Objektivi specifik 5.3 – Sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe rritja e transparencës financiare

Treguesit		Vlera e synuar 2028
Rritja e fondeve publike		Rritja e të hyrave në euro, konform PSFA dhe PSUP
Rritja e të hyrave nga sektori privat		Rritja e të hyrave në euro, konform PSFA dhe PSUP
Rritja e të hyrave nga licencimet		Rritja e të hyrave në euro, konform PSFA dhe PSUP
Rritja e të hyrave vetanake të gjeneruara krijimtaria dhe veprimtaria e IKAU dhe QNLT		Rritja e të hyrave në euro, konform PSFA dhe PSUP
Të hyrat e mbledhura nga donacionet		Rritja e të hyrave në euro
Veprimet e planifikuara		
5.3.1	Zhvillimi i një Grupit Punues gjithëpërfshirës për ngritje të fondeve dhe identifikuar burimet e mundshme të financimit siç janë grantet, donacionet, sponsorizimet, dhe entitetet publike dhe private.	
5.3.2	Krijimi i një ekipi përgjegjës për kërkimin dhe sigurimin e mundësive të reja për financimin e FA.	
5.3.3	Lidhja e partneriteteve me ekonomin, tregtinë, industrinë dhe sektorin privat për kërkime të përbashkëta, projekte novatore dhe iniciativa tjera të cilat gjenerojnë të hyra për FA, të UP.	
5.3.4	Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve, programeve të trajnimit dhe produkteve tjera edukative <i>online</i> për licencim dhe shitje për të gjeneruar të hyra shtesë për FA, rrjedhimisht për UP.	

5.3.5	Zhvillimi dhe platformës digjitale të produkteve tjera edukative <i>online</i> për licencim dhe shitje për të gjeneruar të hyra shtesë për FA, rrjedhimisht për UP.
-------	---

6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Këshilli i Fakultetit të Arkitekturës emëron një komision për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë për Planin e Veprimit. Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat relevante të UP dhe të FA do të monitorojë rregullisht zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe në etapa të caktuara të raportojë. Këshilli Fakulteti të Arkitekturës do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie. Të dhënat që Fakultetit të Arkitekturës dhe zyrat përkatëse do të dorëzojnë në komision për monitorim dhe vlerësim: aktivitetet e realizuara dhe progresin, efektet, ndikimet, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet. Me qëllim të vlerësimit të arritjes së tregueseve, Strategjia parasheh raportimin vjetor, i cili do të ofrojë një pasqyrë me të dhëna të hollësishme mbi arritjen e objektivave strategjike, objektivave specifike, dhe veprimeve të planifikuara,

Zyrtarët përgjegjës do të marrin të dhëna edhe nga donatorët. Për të siguruar monitorimin e duhur të Planit të Veprimit janë përcaktuar treguesit për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Këta tregues do të mundësojnë monitorimin e progresit, duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie. Kjo strategji është një dokument aktiv dhe do të rishikohet e do të plotësohet në baza vjetore. Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie përmes Planit të Veprimit iu siguron zbatuesve të saj një pasqyrë, e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat, me të cilat përballen aktualisht sektori i arsimit të lartë, por edhe në të ardhmen.

Plani i Veprimit i kësaj strategjie do të ndërtohet në një strukturë tabelare, progresi i të cilit do të monitorohet rregullisht në takimet e rregullta të udhëhequra nga Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim i FA të UP. Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase PSFA ka ndikuar në fuqizimin e fakultetit, për të i raportuar në nivel të UP. Vlerësimi i strategjisë do të bëhet dy herë gjatë kësaj periudhe. Vlerësimi i parë do të bëhet në vitin 2026, i cili shërben për të pa nivelin e zbatimit të veprimeve, si dhe në fund të vitit 2028, si vlerësim përfundimtar i Planit Strategjik të FA.

7. NDIKIMI BUXHETOR I STRATEGJISË

Planifikimi strategjik dhe zbatimi i strategjisë për Fakultetin e Arkitekturës ka një ndikim të rëndësishëm në aspektin buxhetor dhe kërkon mobilizimin e burimeve financiare për të realizuar hapat e nevojshëm drejt

qëllimeve të strategjisë në raport me Strategjinë e UP. Përderisa shumica e iniciativave mund të jenë të realizueshme me buxhetin ekzistues, disa prej tyre mund të kërkojnë mbështetje financiare nga donatorët potencialë.

Në përgjithësi, implementimi i planit strategjik mund të sjellë përfitime në aspektin buxhetor në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetësuar. Këto përfitime mund të përfshijnë:

- **Rritjen e të ardhurave**, nëpërmjet rritjes së numrit të studentëve, të zhvillojë programe të reja studimore ose të përmirësojë oferta ekzistuese. Në rritje të të ardhurave të universitetit do të kontribuojnë dhe rritja e numrit të hulumtuesve, fuqizimi i instituteve dhe qendrave.
- **Partneritete dhe donacione**, ku në bazë të këtij plani strategjik, FA përfshin hapa për të siguruar partneritete strategjike me organizata, biznese apo universitete të tjera, si dhe për të zhvilluar marrëdhënie të mira me komunitetin dhe donatorët potencialë. Këto partneritete dhe donacione mund të ndihmojnë në financimin e projekteve specifike apo në sigurimin e burimeve për harkun afatgjatë.
- **Efikasiteti i resurseve**, nëpërmjet rritjes së efikasitetit të operacioneve fakultative, siç janë përmirësimi i proceseve administrative, konsolidimi i strukturave organizative dhe përdorimi i teknologjisë për të rritur efikasitetin. Kjo mund të çojë në ulje të kostove dhe përdorimin më të mirë të burimeve ekzistuese.

Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se ndërhyrjet buxhetore për zbatimin e PSFA varen nga situata specifike financiare dhe disponueshmëria e burimeve në UP. Në këtë drejtim, FA konform PSUP duhet të zhvillojë një plan financiar të qëndrueshëm dhe të konsiderojë burimet potenciale të financimit për të siguruar suksesin e implementimit të planit strategjik 2024-2024. Për më tepër, bashkëpunimi me donatorët, ndërmarrjet, qeverinë dhe partnerët e tjerët është jashtëzakonisht i rëndësishëm. FA i UP ka shpresë se komuniteti i donatorëve do të vazhdojë të mbështesë FA nëpërmjet kontributit financiar për këto iniciativa, ashtu siç kanë bërë në projektet e mëparshme. Kjo mbështetje shtesë do të ndihmojë në realizimin e planeve dhe në forcimin e zhvillimeve pozitive në FA të UP, duke arritur qëllimet e përbashkëta për një arsim të cilësuar dhe një rritje të punësimit të studentëve të FA. Në këtë mënyrë, studentët e diplomuar do të kenë njohuri, aftësi dhe kompetenca që i kërkon tregu i punës.